



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

C.nr. 1193/2019

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN -Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, me zyrtaren ligjore Bionda Rexhepi, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.O, nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson E.H, avokat, nga Gjilani, rr.“”, p.n., kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Burim Maliqi nga Gjilani, me objekt kontesti kompensim i shpërblimit jubilar dhe i shpenzimeve të ushqimit, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, në prezencën e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, më datën 21.04.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.O, nga Gjilani, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit në emër të kërkesës për kompensim të shpërblimit jubilar mbi 20 vite përvojë pune t’ia paguaj 75 % të pagës bazë (paga bazë $421 \times 75\% = 315.75$), përkatësisht shumën prej 315.75 euro, si dhe në emër të kërkesës për kompensim të ushqimit ditor për 791 ditë të pranisë në punë t’ia paguaj nga 2 euro për një ditë të pranisë në punë, përkatësisht shumën prej 1.582.00 euro, gjithësej shumën e përgjithshme për dy kërkesat e cekura më sipër, në lartësi prej 1,897.75 euro, me kamatë ligjore prej 8 %, duke llogaritur nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit A.O, nga Gjilani, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore edhe atë: për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro, për përfaqësim në një seancë gjyqësore shumën prej 135 euro, si dhe për taksë gjyqësore shumën prej 21 euro, apo në shumën e tërësishme prej 260 euro, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Gjykata me qëllim që gjykimi të jetë sa më efikas dhe ekonomikisht i arsyeshëm, në përpjekje që procedura gjyqësore të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, me propozimin e palëve ndërgjyqëse, dhe duke u bazuar në nenin 420 parag.3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK), ka vendosur që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgatitore.

Pretendimet e palëve ndërgjyqjese

Paditësi A.O, nga Gjilani, përmes të autorizuarit të tij, E.H, avokat nga Gjilani, rr. “”, p.n., në këtë gjykatë më datë 26.12.2019 ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensim i shpërblimit jubilar dhe i shpenzimeve të ushqimit. Në padi ka theksuar se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar si mësimëdhënës i ciklit klasor në institucionin arsimor në SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan, dhe i njejtë ka filluar punën nga shtatori i vitit 1992, ashtu që i njejtë ka kryer Fakultetin Edukimit - Programi Fillor, dhe është mësimëdhënës i gjuhës shqipe me orar pune 20 orë në javë, realizon të ardhura mujore të një page neto prej 552.35 euro, ndërsa bruto prej 632.32 euro, ka mbi 20 vite përvojë pune. Nga arsytet e cekura, e duke iu referuar dispozitave të Ligjit të Punës, Ligjit për Arsimin në Komunat e Kosovës, si dhe nenit 35 parag.7 dhe 8 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj ushqimin për ditët e pranisë në punë edhe atë nga 2 euro në ditë, ashtu që për 499 ditë të pranisë në punë ka kërkuar shumë prej 998 euro ndërsa në emër të kërkesës për kompenzim të shpërblimit jubilar për përvojë të punës te e paditura mbi 20 vite ka kërkuar t’i kompensohet 75 % e pagës bazë në shumë prej 467.31 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, e me decidivisht sikurse në këtë padi.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se paditësi kërkesëpadinë e tij e bazon në Kontratën Kolektive të Arsimit të Kosovës (në vijim: KKAK), të datës 18.04.2017, të miratuar dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë (në vijim: MASHT) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (në vijim: SBASHK), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 7 dhe 8 të kësaj kontrate, e sipas të paditurës kjo kontratë nuk prodhon efekt juridik dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunes së Gjilanit, si e paditur në këtë rast, ngase kjo kontratë nuk është në fuqi, pasi që sipas Ligjit nr.04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, të datës 06 Maj 2014 nuk është paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë, dhe se çdo marrëveshje që parashihet të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Si arsye tjetër ka cekur se, Kontrata Kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës, i cili nuk parashihet një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi që neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Tutje ka theksuar se kërkesa e paditësit është parashkruar referuar dispozitës së nenit 353 parag. 3, nenit 357 parag.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimore, nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që paditësi ka mbi 25 vite përvojë pune, e një e drejtë e tillë paditësit i ka takuar pasi që paditësi i ka bërë 20 vite përvojë pune, e nga këto pretendon se paditësi kërkesën e tij e ka bërë pas 5 viteve. Me tej ka cekur se paditësit nuk i takon shpërblimi jubilar edhe nga fakti se KKAK nuk aplikohet te shërbyesit civil, pasi që kjo kontratë është lidhur në bazë të nenit 90 të Ligjit të Punës, e në rastin konkret paditësi gabimisht është bazuar në këtë kontratë pasi që i njejtë ka statusin e shërbyesit civil, sepse shërbyesit civil bien nën ingerencat e LSHC të Kosovës. Pos të cekurave ka theksuar se sipas nenit 90 pika 8 e Ligjit të Punës, për të qenë kontrata në fuqi ligjore duhet të jetë e regjistruar në MPMS, kurse në rastin konkret kjo kontratë nuk është e regjistruar në organin e lartëcekur, ndërsa krejt në fund ka shtuar se nuk janë shtjerrë edhe mjetet juridike

sipas procedurës administrative me qëllim që të inicohet procedura gjyqësore për realizimin e të drejtës së paditësit, e më decidivisht sikurse në përgjigjen në padi.

I autorizuari i paditësit, gjatë seancës për shqyrtim përgaditor dhe kryesor të mbajtur me datë 16.04.2021 ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë padisë, kërkesëpadisë, ndërsa si prova për t'i vërtetuar pretendimet e parashtruara në padi, ka propozuar që të administrohen provat e bashkëngjitura padisë, si dhe provat e dorëzuara në këtë seance, konkretisht Vërtetimin e lëshuar nga SHFMU "Rexhep Elmazi", me nr.prot.38, të datës 01.04.2021 për ditët e pranisë në punë për paditësin; Njoftimin e lëshuar nga SHFMU "Rexhep Elmazi" për kuzhinën e shkollës, të datës 11.02.2020; Pasqyrën e llogarisë, të lëshuar nga Trusti për periudhën 13.02.2019-19.02.2020 dhe Kontratën e punës, 05 nr.1569/2016, të datës 08.07.2016.

Pos të cekurave, i autorizuari i paditësit në fillim të kësaj seance, pra në seancen e datës 16.04.2021 e ka bërë ndryshimin e kërkesëspadisë së paditësit në pikpamje objektiv, ashtu që me padinë e ndyshuar ka kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit A.O dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësit në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për ditë e pranisë në punë t'ia kompensoj nga 2 euro në ditë, edhe atë për ditët nga data 18.04.2017 e deri më datë 31.03.2021, gjithësej për 791 ditë pune t'ia paguaj paditësit shumën prej 1.582.00 euro dhe në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar për 26 vite përvojë pune, duke u bazuar në bazë të të ardhurave personale të paditësit nga 421 euro, shumëzuar me 75 % të pagës bazë t'ia paguaj paditësit shumën prej 315.75 euro, apo shumën e tërësishme prej 1.897.75 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

I autorizuari i të paditurës, gjatë seancës për shqyrtimin përgaditor dhe kryesor të mbajtur me datë 16.04.2021 ka deklaruar se mbeten në tërësi pranë përgjigjes në padi, duke e kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pathemeltë, me arsyetimin se e paditura nuk është nënshkruese e KKAK -së, dhe e njejta nuk prodh efekt juridik ndaj saj, duke ritheksuar se KKAK nuk aplikohet te shërbyesit civil, pasi që e paditura konsideron se paditësi e ka statusin e shërbyesit civil, ngase marrëveshja e lidhur në bazë të nenit 90 të Ligji të Punës, nuk mund të prodhojë efekt juridike ndaj të punësuarve të cilët kanë statusin e shërbyesit civil, pasi që shërbyesit civil bien nën ingerencat e Ligjit për Shërbyesit Civil të Kosovës, me nr.03/L-149. Po ashtu si rrethanë tjetër që arsyeton pretendimet e saj e paditura se paditësi ka statusin e shërbyesit civil iu ka referuar Kontratës së Punës, me nr.prot.1569/2016, të datës 08.07.2016, respektivisht pikës IV të kësaj kontrate, duke theksuar se me këtë kontratë është cekur se sa i përket të drejtave dhe detyrimeve zbatohen dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil. Pos të cekurave, ka shtuar se vërtetimin e pranuar gjatë këtë seance nga i autorizuari i paditësit, me nr.prot.38, të datës 01.04.2021, të lëshuar nga shkolla e cekur, e kundërshton vetem për vitet 2017-2018 dhe 2018-2019, sepse konsideron se është në kundërshtim me nenin 35, parg. 7 të KKAK-së, edhe atë sa përket shpenzimeve të ushqimit për ditë pune, sepse aty ceket për ditët e plota të pranisë në punë, e jo për ditët e lajmërimit në punë, prandaj konsideron se për këto dy vite ka me tepër ditë të shënuara se sa që figurojnë në kalendarin shkollor të MASHT-it, që do të thotë jo me tepër se 185 ditë punë.

Më tej ka shtuar se për të paditurën nuk është kontestuese përvoja e punës së paditësit e as lartësia e kërkesës së paditësit sa i përket lartësise së shpërblimit jubilar. Ndërsa lidhur me provat e dorëzuar gjatë seancecës së mbatur me datë 16.04.2021, i autorizuari i paditësit ka theksuar se do të deklarohet në po këtë seancë, e po ashtu nuk ka kërkuar shtyerjen e kësaj seance edhe pas ndryshimit të kërkesëpadisë së paditësit nga i autorizuari i tij, por ka shtuar se është i gatshëm që të deklarohet për provat e dorëzuara gjatë seancecës dhe për padinë, respektivisht kërkesëpadinë e ndryshuar.

Pas ndryshimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit gjatë seancecës së mbajtur me datë 16.04.2021 dhe deklarimit të të autorizuarit të paditësit se i njejtë është i gatshëm të deklarohet gjatë kësaj seance për padinë e ndryshuar nga i autorizuari i paditësit, gjykata bazuar në dispozitat e nenit 258 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (në vijim: LPK) e ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë së paditësit, e ndaj të cilit aktvendim palët nuk kanë pasur vërejtje.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore në procedurën e provave i ka administruar këto prova: Formularin për kërkesë apo ankesë, me nr.prot.05-610/01-0155356/19, të datës 23.12.2019; Kërkesën për kompensim drejtuar DKA-së në komunën e Gjilanit nga i autorizuari i paditësit, të datës 23.12.2019; Kontratën e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.prot.1228, të datës 01.09.2015; Kontratën e punës, 05 nr.1569/2016, të datës 08.07.2016; Listën e pagave sipas nr.nëp.EM00114513 për paditësin për muajin Shtator 2019; Vërtetimin nga SHFMU “Rexhep Elmazi”, me nr.prot.38, të datës 01.04.2021 për ditët e pranisë në punë për paditësin; Njoftimin nga SHFMU “Rexhep Elmazi” për kuzhinën e shkollës, të datës 11.02.2020; Pasqyrën e llogarisë nga Trust për periudhën 13.02.2019 - 19.02.2020.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në kuptim të nenit 8 të LPK-së, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Me provat e cekura më lartë, përkatësisht me Formularin për kërkesë apo ankesë me nr. protokollit 05-610/01-0155356/19, të datës 23.12.2019, dhe Kërkesën për kompensimin, të datës 23.12.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi paraprakisht ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shpenzimeve për ushqim dhe për shpërblim jubilar, por e paditura ka heshtur në lidhje me këtë kërkesë.

Në bazë të Kontratës së punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, me nr.prot.1228, të datës 01.09.2015, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me datë 01.09.2015, si mësimdhënës i ciklit klasor në SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan, këtu e paditura, ndërsa sipas Kontratës së Punës, 05 nr.1569/2016, të datës 08.07.2016, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka themeluar marrëdhënie pune me datë 08.07.2016, si Drejtor i Shkollës Filllore të Mesme të Ultë, në SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan, këtu e paditura, në kohëzgjatje prej 11.07.2016 deri me datë 11.07.2020.

Në bazë të Vërtetimit të lëshuar nga SHFMU “Rexhep Elmazi”, me nr.prot.38, të datës 01.04.2021 për ditët e pranisë në punë për paditësin, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi është punëtor i kësaj shkolle dhe ka 26 vite përvojë pune, ndërsa si ditë pune gjatë viteve shkollore 2016/2017, 2017/2018, 2018/2019 dhe 2020/2021, llogaritur nga data 18.04.2017 deri më datë 31.03.2021 ka gjithsej 791 ditë pune.

Në bazë të Listës së pagesave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës, për nëpunësin-paditësin, sipas nr.nëp.EM00114513 për muajt Shtator 2019, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka koeficientin 7.8, pagën bruto e ka 623.32 euro, kurse pagën neto e ka 552.35 euro, ndërsa sipas Pasqyrës së llogarisë së lëshuar nga Trusti, gjykata ka vërtetuar faktin se në emër të kontributeve prej muajit janar e deri në muajin dhjetor të vitit 2019 dhe në muajin janar 2020 nga Ministria e Financave janë paguar kontributet pensionale për paditësin, edhe ate nga 31.17 euro për çdo muaj, ashtu që 31.17 euro janë paguar nga paditësi dhe 31.17 euro nga Ministria e Financave.

Në bazë të Njoftimit të lëshuar nga SHFMU “Rexhep Elmazi” për kuzhinën e shkollës, të datës 11.02.2020, gjykata ka vërtetuar se shkolla e cekur më lartë nuk ka kuzhinë për përgaditjen e ushqimit dhe asnjë punëtor i kësaj sholle nuk shërbehet në shkollë me ushqim e as nuk kanë kushte për përgaditje.

Nga administrimi i gjithëmbarshtëm i provave dhe nga deklarimi i të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse gjatë seancës së mbajtur me datë 16.04.2021, gjykata ka gjetur se në këtë çështje kontestimore nuk ishte kontestues fakti nga palët ndërgjyqëse se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura, e po ashtu nuk ishte kontestues as përvoja e punës së paditësit e as lartësia e kërkesëpadisë së paditësit sa i përket kërkesës për kompensim të shpërblimit jubular, mirëpo, si kontestuese për palën e paditur ishte baza juridike e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit dhe ngritja e prapësimi material lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit.

Baza juridike

Me nenin 90 të Ligjit të Punës, është paraparë se: ”1.Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet:1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në:2.1. nivel të vendit,2.2. nivel të degës,2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet. 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive. 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj”, ndërsa me nenin 4 parag.2 të po këtij ligji, është paraparë se: “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, sipas nenit

8, parag. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (në vijim: LMD), është paraparë se: “Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit”. Sipas nenit 35 parag.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 18.04.2017, të nënshkruar në mes të Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (SBASHK), dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është paraparë se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarëve, përmes restaurantit a kuzhinës, osë në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin e ushqimit”, ndërsa sipas nenit 35, parag. 8, pika 8.2 të kësaj Kontrate, është përcaktuar qartëse: “Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit në vlerë prej: për 20 vite të përvojës së punës në vlerë prej 75 % të një page bazë”, ndërsa me pikën 8.5 të po këtij neni parashihet se: “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuari i ka plotësuar kushtet e shpërbilimit sipas kritereve përkatëse”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe të njëjtën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar, pasi që nga provat e administruara dhe fakteve jokontestuese ka vërtetuar faktin se paditësi nga data 01.09.1994 ka filluar të punoj në SHFMU “Rexhep Elmazi” në Gjilan, kurse aktualisht është duke punuar si drejtor i kësaj shkolle, ka përvojë pune 26 vite, realizon të ardhura mujore të një page bazë në shumë prej 421 euro, dhe si ditë të pranisë në punë nga data 18.04.2017 e deri më datë 31.03.2021 ka gjithsej 791 ditë pune. Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, e duke bazuar në dispozitat e cekura më lartë, përkatësisht në nenin 35 parag. 7 dhe 8 pika 8.2 të KKAK, gjykata gjeti se paditësit në emër të kërkesës për kompensim të shpërbilimit jubilar për përvojë të punës mbi 20 vite te e paditura i takon e drejta e pagesës së shpërbilimit jubilar të 75 % të një page bazë, e në rastin konkret paditësi pagën bazë e ka 421 euro (fakt ky i jokontestues nga palët ndërgjyqëse), andaj llogaritur paga bazë e paditësit prej 421 euro me 70 % ($421 \times 75 \% = 315.75$) rezulton se paditësit i takon e drejta për shpërbilim jubilar në lartësinë e aprovuar nga gjykata në shumë prej 315.75 euro, ndërsa në emër të kërkesës për kompensim të ushqimit për 791 ditë të pranisë në punë, paditësi ka të drejtë në pagesë të ushqimit ditor nga 2 euro gjatë ditëve të pranisë në punë, andaj gjykata duke pas parasysh faktin se e paditura nuk posedon kuzhinë për përgaditjen e ushqimit për punëtorët e saj, e në rastin konkret paditësit nuk iu ka siguruar ushqim edhe pse e paditura ka pasur detyrim sipas dispozitës së cekur më lartë, fakt ky i vërtetuar me Njoftimin e lëshuar nga SHFMU “Rexhep Elmazi”, i datës 11.02.2020, prandaj gjykata nga këto arsye, për 791 ditë të pranisë në punë, llogartur nga 2 euro për një ditë ($791 \times 2 = 1.582.00$) paditësit i ka aprovuar kërkesën për shumën e kërkuar prej 1,582.00 euro.

Lidhur me pretendimin e të paditurës të parashtruar në përgjigjen në padi dhe gjatë seancës së mbajtur se KKAK nuk prodhon efekt për të paditurën nga, gjykata vlerëson se një pretendim i

tillë nuk qëndron sepse KKAK është lidhur në nivel vendi sipas dispozitave të Ligjit të Punës (neni 90 i këtij Ligji), çka nënkupton se meqë Kontrata është e lidhur në nivel vendi e njehta prodhonë efekt juridik edhe ndaj të paditurës. Përveç kësaj, me dispozitën e nenit 2 parag.1 pika 1.1 të kësaj KKAK-së, është përcaktuar qartë se: “Dispozitat e kësaj kontrate janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet e Arsimit Parauniversitar.....” , ndërsa me pikën 1.2 të po këtij neni, është cekur se: “Dispozitat e kësaj Kontrate janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e arsimit (Komunat-DKA, KD të Universiteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj)...”. Në interpretim të kësaj dispozite, gjykata vlerëson se e paditura ka përgjegjësi në përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara nga Kontrata Kolektive e Arsimit, pasi që me këtë dispozitë është cekur qartë se të punësuarit por edhe punëdhënësit janë të detyruar t’i zbatojnë dispozitat e kësaj kontrate, andaj edhe të njejtët janë përgjegjëse në përmbushjen e detyrimeve të cilat dalin nga kjo kontratë.

Ndërsa sa i përket pretendimin tjetër të paditurës të parashtruar në përgjigjen në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 16.04.2021 se paditësi e ka statusin e shërbyesit civil dhe ndaj tij nuk gjejnë zbatim dispozitat e KKAK-së, sipas gjykatës ky pretendim nuk qëndron, ngase pozita e paditësit hynë në kategorinë e nëpunësve civil sipas Ligjit për Shërbyesit Civil (në vijim: LSHC), e rrejdhimisht dispozitat e këtij ligji nuk mund të aplikohen për rastin konkret, pasi që mënyra e themelimit të marrëdhënies së punës të drejtat dhe përgjegjësit e drejtorëve të shkollave rregullohen me Ligjin mbi Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar, dhe me akte tjera nënligjore për zbatimin e ligjeve në fjalë, mirëpo në rastet kur me dispozitat e ligjeve të cekura më lartë si ligje të veçanta nuk janë paraparë dispozita të veçanta për zgjidhjen e çështjeve nga marrëdhënia e punës, sipas vlerësimit të gjykatës aplikohen dispozitat e Ligjit të Punës (neni 2 parag. 2 i këtij Ligji), kjo ngase, vendi i punës së paditësit dhe pozita e shërbyesit civil siç pretendon e paditura kanë dallime esenciale në të gjitha aspektet, pasi që te shërbyesit civil marrëdhënia e punës themelohet me akt emërim referuar LSHC, i cili ka qenë në fuqi në kohën e themelimit të marrëdhënies së punës së paditësit, ndërsa në rastin konkret paditësi marrëdhënien e punës e ka themeluar me kontratë pune, fakt ky i vërtetuar me provat e cekura më lartë, prova këto të administruara (kontratat e punës). Pastaj referuar po ashtu LSHC, në shërbimin civil të Kosovës janë dy kategori të punësuarve, edhe ate, pozitat e nëpunësve civilë të karrierës me mandate të përhershëm dhe pozitat e nëpunësve civilë të jo karrierës me kohëzgjatje të kufizuar deri në 2 vjet, e që në rastin konkret drejtori i shkollës ka mandate 5 vjeçar, dhe pas përfundimit të mandatit, drejtorit i ruhet pozita e mësimdhënësit në sistemin arsimor. Vlenë të ceket se te shërbyesit civil komisioni për rekrutim të shërbyesve civil përbëhet nga 5 antarë, ndërsa komisioni për pozitën e drejtorit të shkollës përbëhet nga 3 antarë, krahasime këto referuar dispozitave të LSHC, ligji ky i cili ka qenë në fuqi në kohën kur paditësi ka parashtruar padi dhe kohën kur paditësi ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e drejtorit, i cili ligj tani më është shfuqizuar me Ligjin për Zyrtarët Publik, dhe dispozitave të Udhëzimit Administriv të MASHT nr. 08/2014 për Procedurat dhe Kriteret e Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendës Drejtorit të Institucionit Edukativo –Arsimor dhe Aftësues, udhëzim ky i cili ka qenë në fuqi gjatë kohës kur paditësi ka themeluar marrëdhënie pune te e paditura si drejtor në shkollën e cekur më lartë, i cili udhëzim tani është shfuqizuar me Udhëzimin Administrativ të MASHT nr.15/2019 për Detyrat, Përgjegjësit, Procedurat dhe Kriteret e

Zgjedhjes së Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit në Institucion Publik Edukativo –Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar. Pra, të gjitha procedurat e themelimit të marrëdhënies së punës për pozitën drejtor shkolle, duke filluar nga rekrutimi, akti me të cilin themelohet marrëdhënia e punës, procedurat disiplinore, transferimet, pushimi, dhe procedurat e tjera, janë të rregulluar me ligjet e cekura më lartë. Përveç të lartëcekurave, nga Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar, e lidhur në mes paditësit dhe organit të paditurës, sipas nr.prot.1228, të datës 01.09.2015 në hyrje të kësaj kontrate rezulton se janë bazuar në dispozitat e Ligjit të Punës, ndërsa me Kontratën tjetër të punës të lidhur po ashtu nga po këto palë, 05 nr.1569/2016, të datës 08.07.2016 shihet se është cekur se si dispozita të aplikueshme janë përmendur dispozitat e LGJC, mirëpo gjykata nuk e ka të qartë se si është themeluar marrëdhënia e punës me këtë kontratë kur dihet se të shërbyesit civil mardhënia e punës pas konsumimit të procedurës së rekrutimit themelohet me akt emërim ashtu siç edhe u cek më lartë, andaj duke pas parasysh dispozitat e ligjeve të cekura më lartë dhe aktet nënligjore të cilat janë nxjerrë në zbatim të ligjeve në fjalë , gjykata ka gjetur se paditësi nuk e ka statusin e shërbyesit civil. Pos kësaj, gjykata gjatë gjithë procedurës sipas detyrës zyrtare kujdeset për kompetencën e vet lëndore, e në këtë rast ka gjetur se kjo gjykatë është kompetente për të vendosur për këtë çështje kontestimore, prandaj edhe ka shqyrtuar dhe vendosur lidhur me këtë çështjeve juridike kontestimore.

Kurse sa i përket pretendimit të parashtruar nga i autorizuari i të paditurës gjatë seancës së mbajtur me datë 16.04.2021 se Vërtetimi, me nr.prot.38, i datës 01.04.2021, i lëshuar nga shkolla e cekur më lartë, në vitet 2017-2018 dhe 2018-2019 është në kundërshtim me nenin 35, par. 7 të KKAK-së, edhe atë sa përket shpenzimeve të ushqimit për ditë pune nga arsyet e cekura se në këtë vërtetim ceket për ditët e plota të pranisë në punë, e jo për ditët e lajmërimit në punë, dhe se konsideron se për këto dy vite ka me tepër ditë të shënuara se sa që figurojnë në kalendarin shkollor të MASHT-it, gjykata edhe një pretendim të tillë nuk mund ta pranoj si të bazuar ngase ky vërtetim është lëshura nga shkolla ku punon paditësi, e po ashtu kjo shkollë është nën kompetenca të menaxhimit të të paditurës, prandaj për gjykatën ky dokument është i besueshëm dhe i pranueshëm derisa nuk vërtetohet e kundërta me prova konkrete. Në rastin konkret e paditura vetëm ka kontestuar ditët e pranisë në punë të paditësit gjatë viteve shkollore 2017/-2018 dhe 2018-2019 mirëpo për ti vërtetuar pretendimet e saj nuk ka prezantuar ndonjë provë për të vërtetuar këto pretendime ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 7 dhe 319 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, prandaj gjykata në mungesë të provave këto pretendime nuk i mori parasysh.

Lidhur me pretendimin tjetër të të paditurës ku ka theksuar se në bazë të nenit 90 pika 8 të Ligjit të Punës, për të prodhuar efekt juridik KKAK e njehta do të duhej të jetë e regjistruar në faqen e MPMS-së, për gjykatën edhe ky pretendim është i pabazuar dhe të njejtin nuk e mori për bazë, pasi që, sipas vlerësimit të gjykatës nuk është relevant fakti se a është regjistruar apo jo KKAK në faqen e MPMS, sepse referuar nenit 47 të KKAK-së është paraparë se pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët, e njehta regjistrohet dhe depozitohet në MASHT e jo në ndonjë organ tjetër siç pretendon e paditura, kjo për faktin se kjo kontratë është sektoriale dhe jo e përgjithshme dhe e njëjta prodhon efekt juridik vetëm për të punësuarit dhe punëdhënësit në sektorin e arsimit (neni 2 i KKAK). Sido që të jetë, akti i regjistrimit dhe depozitimi i

kontratave, sikurse kjo në rastin konkret i KKAK-së ka qenë përgjegjësi e karakterit administrativ e organit publik kompetent që të njejtën t'a regjistroj apo depozitoj, e për të cilat lëshime eventuale nuk mund të kenë konsekuenca të punësuarit, e në këtë rast nuk mund të pësoj paditësi.

Po ashtu, gjykata lidhur me pretendimin e të paditurës ku është thirrur në parashkrim të kërkesës se paditësit, vlerëson se një pretendim i tillë nuk qëndron, pasi që padia në gjykatë është parashtruar nga paditësi me dt. 28.12.2019, pra, pas hyrjes në fuqi të KKAK, sepse KKAK ka hyrë në fuqi me dt.18.04.2017, e nisur nga rrethana të tilla rezulton se paditësi nuk ka pasur bazë ligjore për parashtrimin e padisë para kësaj date, pra, para dt.18.04.2017, çka do të thotë padia është parashtruar në afatin e paraparë ligjor prej 3 viteve ashtu siç është përcaktuar me nenit 87 të Ligjit të Punës, i cili nen mes tjerash ka paraparë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës”, çka nënkupton se kërkesëpadija e paditësit nuk është përfshirë në parashkrim ashtu siç pretendon e paditura sepse paditësi padinë në gjykatë e ka parashtruar brenda afatit të paraparë ligjor.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se paditësja fillimisht nuk i ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative para se të paraqes padi në gjykatë, mirëpo për gjykatën edhe ky pretendim i të paditurës është i pabazuar, pasi që, në bazë të shkresave të lëndës dhe provave të administruara, përkatësisht Formularit për kërkesë apo ankesë me nr. protokollit 05-610/01-055356/19, të datës 22.01.2020 dhe Kërkesës për kompensimin, të datës 23.12.2029, rezulton se paditësi fillimisht iu ka drejtuar me kërkesë të paditurës për realizimin e të drejtës së tij, por e paditura nuk iu ka përgjigjur kërkesës së paditësit. Përveç kësaj, gjykata vlerëson se meqë e drejta e punës është kategori kushtetuese dhe e garantuar konventa ndërkombëtare dhe me ligj, në rast të paraqitjes së kërkesës së punonjësit për kompensim dëmi apo në kërkesat e tjera në të holla-para nga marrëdhënia e punës (kërkesat materiale) punonjësi nuk ka nevojë që paraprakisht t'i drejtohet punëdhënësit me kërkesë për mbrojtjen e të drejtave të tij si kusht themelor për parashtrimin e padisë në gjykatë, e kjo duke u bazuar në nenit 87 të Ligjit të Punës, pasi që me dispozitën e këtij neni është paraparë qartë se: “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”, andaj nga kjo dispozitë rezulton se paditësi brenda afatit të cekur më lartë mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore për kërkesat të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës në para, mirëpo kjo nuk nënkupton se paditësi nuk mund të kërkojë mbrojtje gjyqësore pa i shtjerr mjetet juridike të e paditura ashtu siç pretendon e paditura, kjo ngase e paditura ka pas obligim ligjor që të përmbush detyrimin e saj ndaj paditësit në shumën e kërkuar dhe të aprovuar me kërkesëpadi në bazë të dispozitave të cekura më lartë.

Nga gjendja faktike e vërtetuar dhe në bazë të dispozitave ligjore të cekura më lartë, duke pas parasysh faktin se paditësi i ka lindur e drejta për të kërkuar në rrugë gjyqësore realizimin e të drejtës së tij lidhur me kërkesën e parashtruar, i njëjti si palë e legjitimuar ka të drejtë që të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura, sepse, sipas nenit 245 të LMD-së, në mënyrë të qartë është paraparë se: “Kreditori në marrëdhëniet e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të

kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”, andaj gjykata gjeti se e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e saj ndaj paditësit, ku edhe vendosi që ta detyrojë të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shumën e kërkuar dhe të aprovuar nga gjykata.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispoziten e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata ka vlerësuar dhe theksimet e tjera të palëve ndërgjyqëse, por ka gjetur se të njëjtat janë irelevante në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Gjykata duke patur parasysh suksesin në procedurë të paditësit dhe duke u bazuar në nenin 449, 452 dhe 463 parag.1 të LPK-së dhe nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullores për Tarifat e Avokatëve, të datës 18.03.2017, ka aprovuar në tërësi kërkesën për shpenzimet e kërkuara nga e autorizuara e paditësit, ashtu që e ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, edhe atë: në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 euro; në emër të taksës gjyqësore për paraqitjen e padisë shumën prej 31 euro dhe në emër të përfaqësimit të paditësit për një seancë shumën prej 135 euro, gjithsej shumën prej 270 €.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

C.nr. 1193/2019, më datë 21.04s.2021

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIMI JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë ankese, në afat prej 7 ditëve, pas ditës së pranimit të të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2020:028906
Datë: 09.03.2021
Numri i dokumentit: 01576822